



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhe, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “SHERBIMI I MBAJTJES NEN KONTROLL TE QENVE  
ENDACAKE PER VITIN 2023”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 85200000-1

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2,081,625 (dy milion e tetedhjetë e një mijë e gjashtë qind e njetzet e pese) Lek pa Tvsh.

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

#### **1.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kerkohet kjo vlere duke marre ne konsiderate rendesine e sherbimit qe kerkohet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”, ku parashikohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per

procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

*ose*

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 10 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj si dhe rendesine e vecante qe shfaq ky sherbim. Përvoja e mëparshme është element shumë i rendesishem që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur me license per Klinike Veterinare me kod II.2.C.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqesë licensen me kodin II.2.C per Klinike Veterinare.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në kreun VI, pika 3 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë license për Klinike Veterinare për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Gjithashtu në termat e references patrashikohet se *“Kastrimi dhe Sterilizimi i cili duhet të bëhet nga klinika të licencuara. Para operacionit kafshët duhet të lihen në vende të përshtatshme, të pastra dhe me kushte klimatike të përshtatshme. Për çdo rast duhet të bëhet trajtimi pre-operator i kafshëve dhe dieta e tyre në mënyrë që operacionet të rezultojnë me sukses maksimal. Operacioni duhet të bëhet nga mjekë veterinar profesionist, të licensuar nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar për ushtrimin e profesionit”*. Sa me sipër për realizimin e këtij shërbimi OE, duhet që minimalisht të jenë të licensuar për Klinike Veterinare.

**2.3.3** Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës për periudhën Janar 2023 – Mars 2023, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

*Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën 2 muajt e fundit, tregojnë besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindëse për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se rëndësia e këtij shërbimi për AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata

tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**2.3.4.** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik si me poshte:

- a- Të paktën 1 (nje) mjekë veteriner (Diplome Universitare dhe license nga Urdhri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për ushtrimin e profesionit.)
- b- Të paktën 1 (nje) teknik veteriner (Diplome të Shkolles së Mesme)
- c- Të paktën 1 (nje) punonjës të çertifikuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar për trajtimin e kasfsheve endacake. (Çertifikate trajnimi)

Për plotësimin e këtij kriteri OE-te duhet të paraqesin: Diplomat, Licensen nga Urdhri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për ushtrimin e profesionit, Kontratën e punës dhe Certifikatat e trajnimit sipas shënimeve të mesiperme, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

*Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kreun VI, pika 3 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik për afatin e kërkuar në listëpagesa i vërteton AK se operatori ekonomik ka një staf të qëndrueshëm, operativ i cili do të kryejë shërbimin në kohë dhe cilësi.

Gjithashtu, në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, ky kriter është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, si dhe shtrirjen e tij në territor.

Ky kriter është vendosur edhe bazuar në kreun VI, pika 3 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, parashikohet se: “**VI. MBIKËQYRJA DHE MBAJTJA NËN KONTROLL E QENVE DHE MACEVE ENDACAKE PA PRONARË** 1. Njësitë e qeverisjes vendore hartojnë programe pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si dhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre. 2. Njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ato administrojnë. 3. Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë

***sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve e maceve të rrugës dhe grumbullimin e tyre në vende të posaçme, të miratuara nga autoritetet e qeverisjes vendore në zbatim të ligjit”.***

Po ashtu Njësia e Prokurimit konstaton se në termat e referencës së procedurës së prokurimit ndër të tjera parashikohet se: *Kapja duhet të bëhet me metoda bashkëkohore nga përsona të specializuar për trajtimin e kafsheve endacake, te cilet duhet te jene të çertifikuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar.*

*Kapja duhet të bëhet nga mjek veteriner te cilet duhet te mbeshteten nga punonjes me njohuri teknike (teknik te mesem ne fushen e vetrinarise), dhe trajtimi i kafsheve te behet me preparate mjekesore te cilat nuk shkaktojne efekte anësore tek kafshët.*

*Me anë të kësaj metode mënjanohej stresi ndaj kafshëve, lëndime e ndryshme si nga kafshët por edhe njerëzit të cilët i kapin.*

*Gjithashtu duhet te mënjanohej cdo forme dhune apo lëndime gjatë kapjes, si dhe metodat e kapjes se tyre nuk duhet te shfaqin shqetesime tek njerëzit e tjerë sidomos tek turistët.*

*Për efekt të fluksit të qenëve duhet të ketë minimalisht dy grupe pune për kapjen e tyre dhe ne perberje te cdo grupi pune duhet te jete te pakten nje mjek veteriner, pasi gjate kapjes se tyre duhet te tregohet kujdes i veçante sepse trajtimi i kafsheve dhe kujdesi ndaj tyre eshte shume i rendesishem.*

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave të mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit si edhe përgjigjet testit të proporcionalitetit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, kryerjen e shërbimit nga operatorë të kualifikuar e te cilet disponojne staf te specializuar per realizimin e kontrates.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar me kod II.8.A, “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”, ose te disponoje nje kontrate bashkepunimi me nje subjekt te licensuar kod II.8.A “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”.

Per kete duhet te paraqese:

- Ne rast se OE eshte i licensuar, duhet të paraqitet licensa me kodin II.8.A “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”.
- Ndersa ne rast te disponimit me kontrate bashkepunimi krahas licenses me kodin II.8.A “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”, duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera

nënligjore të përbashkëta”, si dhe ne kreun VI, pika 4 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të licensuar me kod II.8.A, “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”, ose disponojne nje kontrate bashkepunimi me nje subjekt te licensuar kod II.8.A “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”.

Ky kriter eshte vendosur edhe bazuar ne kreun VI, pika 4 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore” parashikohet se: *Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë transportin e maceve dhe të qenve të rrugës me mjete që respektojnë standardet e mirëqenies së tyre drejt vendeve të miratuara nga autoritetet e njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*

Gjithashtu ne termat e references parashikohet se “*Një kujdes i vecantë duhet të tregohet edhe gjatë transportit nga klinika për në destinacion e qenëve endacake pasi, në këto kushte ato janë me imunitet te dobët për shkak të trajtimit mjekesor. Në cdo rast të transportit të kafshëve nga vendi i trajtimit mjekesor per në destinacionin ku do te leshohen, **mjeti duhet të dezinfektohet**, për shkak se nuk duhet të kalojnë sëmundjet nga qentë qe kapen tek ato të trajtuar qe leshohen. Rekomandohet që kontraktori të jete i licensuar ne fushen e dezinfektimit, pasi eshte e nevojshem dezinfektimi periodik i mjetëve dhe klinikës të cilët do të bëjnë trajtimin e qenëve endacakë”.*

Sa me siper me qellim kujdesin maksimal ndaj shendetit te qenve nevojitet qe OE-te te jene te licensuar me kod II.8.A, “Per sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (dezinfektim, denzinsektim, deratizim)”, ose te sigurojne kete sherbim me kontrate bashkepunimi.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet te disponoje në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje Klinike veterinare te licensuar brenda territorit te Bashkise Lezhe.

Per kete duhet te paraqesë:

- Ne rast te disponimit te klinikes ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni qe provon pronesine dhe licenca me kodin II.2.C per Klinike Veterinare me adrese veprimtarie brenda territorit te Bashkise Lezhe.
- Ndersa per kliniken e marre me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperem, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe ne kreun VI, pika 3 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për



përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje Klinike veterinare te licensuar brenda territorit te Bashkise Lezhe.

Ne termat e references patrashikohet “*Meqenese, për shkak të gjendjes sedative të kafshëve dhe nevojës për një vlerësim paraprak të gjendjes shendetesore, transporti nga vendi i kapjes deri në klinike duhet të zgjasë jo më shumë se 20 (njëzet) minuta, pasi kafshet mund të pesojnë demtime gjate kapjes apo transportimit dhe mund të nevojitet trajtim i specializuar në klinike veterinarie të licensuar e pajisur me pajisjet e nevojshme për trajtimin mjekësor të tyre. Sa me sipër kontraktori duhet të disponojë të paktën një klinike veterinarie të licensuar brenda territorit të Bashkise Lezhe”.*

Gjithashtu në termat e referencës parashikohet se “*Kastrimi dhe Sterelizimi i cili duhet të bëhet nga klinika të licencuara. Para operacionit kafshët duhet të lihen në vende të përshtatshme, të pastra dhe me kushte klimatike të përshtatshme. Për çdo rast duhet të bëhet trajtimi pre-operator i kafshëve dhe dieta e tyre në mënyrë që operacionet të rezultojnë me sukses maksimal. Operacioni duhet të bëhet nga mjekë veterinar profesionist, të licensuar nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar për ushtrimin e profesionit.”*

Sa me sipër me qëllim kujdesin maksimal ndaj shëndetit të qenve nevojitet që OE-te të disponojnë minimalisht një klinike veterinare brenda territorit të Bashkise Lezhe.

Me qëllim dhenien mundësi për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi është lënë e hapur forma e disponimit, si në pronësi ashtu edhe me qira ose kontrate bashkepunimi.

**2.3.7** OE duhet të disponojë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi një automjet të licensuar për transportin e kafshëve të leshuara nga instancat e Shërbimit Veterinar Shtetëror.

Për këtë duhet të paraqesë:

- Në rast të disponimit të automjetit në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore si dhe licencën për transportin e kafshëve të leshuara nga instancat e Shërbimit Veterinar Shtetëror.
- Ndërsa për mjete të marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kreun VI, pika 4 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë se kane në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike, për të përmbushur kontratën.

Ne kreun VI, pika 4 e VKM-se nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore” parashikohet se: *Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë transportin e maceve dhe të qenve të rrugës me mjete që respektojnë standardet e mirëqenies së tyre drejt vendeve të miratuara nga autoritetet e njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*

Numri dhe lloji i mjetit ne pronesi ose qira ose kontrate bashkepunimi eshte vlerësuar si e nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimit sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës duke qene se shërbimi qe kerkohet shtrihet ne nje hapësire te larget gjeografike qe perfshin Bashkine Lezhe dhe 8 njesite Administrative.

Per me teper ne termat e references parashikohet se: *transporti duhet të bëhet me mjete të specializuara dhe të lejuara për transportin e kafshëve nga instancat e Shërbimit Veterinar Shtetëror*, eshte e nevojshem qe transporti i tyre te behet me mjete te lejuara per transportin e kafsheve.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen**

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Njesia pergjegjese ka hartuar termat e references, ne te cilen thekson se jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne termat e references argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**